

VENDIM
Nr. 840, datë 27.9.2013

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 833, DATË 18.9.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRIËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 833, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në ndarjen I, pas fjalëve “... fushave të përgjegjësisë shtetërore...” shtohen “... e të organeve të varësisë...”.

2. Pas ndarjes III shtohet ndarja IV, me këtë përmbajtje:

“IV. Në përmbushje të misionit dhe të kompetencave të saj, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka organet e varësisë, si më poshtë vijon:

a) Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN);

b) Agjencinë Kombëtare Atomike (AKA);

c) Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH);

ç) Repartin e Inspektim-Shpëtim Minierave (RISHM);

d) Inspektoratin Qendror Teknik (IQT);

dh) Sekretariati “Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse” (NTIN).

Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka në varësi administrative shoqëritë dhe ndërmarrjet në likuidim që veprojnë në fushën e përgjegjësisë së saj, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama